Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

**MENDIM**

**Data e miratimit: 13 nëntor 2015**

**Lënda nr. 85/10**

**B. K.**

**kundër**

**UNMIK-ut**

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 13 nëntor 2015,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

## I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 30 mars 2010 dhe është regjistruar më 22 prill 2010.

2. Më 29 dhjetor 2010, ankuesi i ofroi Panelit informata shtesë.

3. Më 16 mars 2012, Paneli njoftoi për ankesën Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 21 maj 2012.

4. Më 14 maj 2012, Paneli ia përcolli dokumentacionin shtesë PSSP-së dhe e ftoi UNMIK-un qëtë japë komente shtesë mbi pranueshmërinë në dritë të dokumentacionit të pranuar. Më 21 maj 2012, Paneli pranoi përgjigjen e UNMIK-ut.

5. Më 22 gusht 2012, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

6. Më 7 shtator 2012, Paneli ia përcolli vendimin e vet PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 31 tetor 2012.

7. Më 9 nëntor 2012, Paneli ia përcolli ankuesit përgjigjen e UNMIK-ut duke kërkuar nga ai që të japë komente shtesë nëse ai dëshironte ta bënte këtë.

8. Më 6 dhjetor 2012, Paneli pranoi komentet shtesë të ankuesit. Komentet e tjera nga ankuesi u pranuan nga Paneli më 17 janar 2013.

## II. FAKTET

*Historiku: korniza ligjore dhe politike për kthimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë sipas UNMIK-ut*

9. Gjatë fillimit të 1990-ve shumë njerëz që jetonin në atëherë Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, duke përfshirë personat nga Kosova, u larguan apo ikën nga territori, në shumë raste si pasojë e luftës dhe armiqësive. Kur situata në Kosovë u stabilizua, ato vende mikpritëse që kishin pranuar njerëz nga Kosova gjatë konfliktit, kërkuan nga autoritetet e Kosovë që t'ipranojnë në mënyrë progresive të kthyerit.

10. Pas vitit 1999 UNMIK-u, i mandatuar sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999), në mes tjerash, për të krijuar "një ambient të sigurt në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur do të mund të ktheheshin të sigurt në shtëpi", ishte institucioni kryesor që menaxhonte kthimin e personave të riatdhesuar në Kosovë, duke përfshirë ata që ishin riatdhesuar në mënyrë të pavullnetshme. Duke filluar nga viti 2006, në kontekst të transferimit gradual të kompetencave tek Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisje (IPVQ) të Kosovës, UNMIK-ut mbështeti IPVQ-të në krijimin e një politike dhe strategjie për të ndihmuar kthimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës.

11. Më 28 nëntor 2007, PSSP-ja i UNMIK-ut aprovoi një Politikë të kthimit që paraqiste "strategjinë dhe procedurat në Kosovë për trajtimin e kthimeve të personave me origjinë nga Kosova dhe që qëndronin pa status ligjor në vendet mikpritëse", të përgatitur së bashku nga UNMIK-u dhe IPVQ-të dhe, si e tillë, e pranuar nga të fundit më 31 tetor 2007. Strategjia e

ndërlidhur për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë ishte miratuar nga Qeveria e Kosovës më 10 tetor 2007[1].

12. Për sa i përket procedurave të kthimit, në Politikën e kthimit specifikohej që, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të 15 majit të vitit 2001 *mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*, UNMIK-u ruante "kompetenca të rezervuara në lidhje me çështjet e ndërlidhura me marrëdhëniet me jashtë dhe kontrollit të kufirit, duke përfshirë kthimin e personave me origjinë nga Kosova" dhe që "transferimi i plotë i këtyre kompetencave tek IPVQ-të "nuk do të përfundojë derisa të vendoset statusi përfundimtar i Kosovës". Prandaj, sipas Politikës për kthim, "gjatë kësaj periudhe kalimtare, ndërsa kompetencat e përgjithshme mbesin tek UNMIK-u -[Zyrës për Komunitete, të Kthyerit dhe Minoritete], IPVQ-ve [Ministrisë së Punëve të Brendshme] do t'i dorëzohet përgjegjësia funksionale/operacionale për zbatimin e kompetencave të lartpërmendura". Në politikën e kthimit qartësohej më tutje që, deri te transferimi i plotë i kompetencave tek IPVQ-të, UNMIK-u do të ishte "pika e parë e kontaktit" për vendet mikpritëse për t'ia përcjellë kërkesat për kthim, të cilat duhet të përmbajnë informata siç janë detajet për personat që do të riatdhesohen dhe të dhëna për përgatitje të veçanta për të cilat mund të ketë nevojë personi në fjalë, duke përfshirë kur është e nevojshme "informata përgjendjet shëndetësore"[2].

13. Në politikën përkthim thuhej që IPVQ-të/autoritetet e Kosovës do të bëjnë përpjekje qëtë krijojnë "kushte të përshtatshme" për personat që përballen me riatdhesim nga vendet mikpritëse, duke përfshirë mjetet që ndihmojnë ri-integrimin e tyre (p.sh. qasje në akomodim të përkohshëm dhe strehim afatgjatë, përkujdesje shëndetësore, arsim dhe punësim) siç specifikohet në strategji.

14. Në kuadër të IPVQ-ve, Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) i ishte besuar roli udhëheqës në implementimin e politikës përkthim, duke përfshirë përgjegjësinë për të menaxhuar riatdhesimet e pavullnetshme dhe bashkërendimin me ministritë e tjera të linjës dhe komunat për të krijuar dhe zbatuar politika të përshtatshme për kthim. MPB-ja e kishte, po ashtu, përgjegjësinë qëtë vazhdojë dhe bashkërendojë procedurën e kthimit në një mënyrë të tillë që "grupet e cenueshme të marrin ndihmë të mjaftueshme gjatë gjithë procesit", veçanërisht duke i referuar rastet e tilla në mekanizmat për ri-integrim dhe duke informuar aktorët relevantë (siç janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunat), me qëllim që të ndihmohet kthimi i atyre personave[3].

15. Në politikën përkthim thuhej që të dyja UNMIK-u dhe IPVQ-të e kishin për obligim që të "sigurojnë kthim të sigurt dhe të dinjitetshëm të personave që i janë nënshtruar kthimit të pavullnetshëm dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për kthim në Kosovë" dhe t'i zbatojnë plotësisht standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut "gjatë gjithë procesit të kthimit"[4].

---

[1]UNMIK-IPVQ, Strategjiapërri-integrimtëpersonavetëriatdhesuar, e miratuarmë 10 tetor 2007.

[2] UNMIK-IPVQ, Politika e kthimit, e finalizuarngaGrupipunuespërriatdhesimmë 10 maj 2007, e miratuarnga PSSP-jamë 28 nëntor 2007, nëfaqe12-13.

[3]UNMIK-IPVQ, Politika e kthimit e përmendurnë §12 mëlart, nëfaqen 9.

[4]UNMIK-IPVQ, Politika e kthimit, e përmendurnë §12 mëlart, nëfaqen 16.

16. Pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të kryejë efektivisht pjesën më të madhe të detyrave të veta si administratë e përkohshme, dhe PSSP-ja nuk ishte në gjendje të zbatojë autoritetin ekzekutiv që zyrtarisht i është besuar atij sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) (shih, p.sh., Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 12 qershor 2008, S/2008/354, §§ 7 dhe 17; Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 15 korrik 2008, S/2008/458, §§ 3-4 dhe 29; Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 24 nëntor 2008, S/2008/692, § 21). Prandaj, pas kësaj date, të gjitha kompetencat politike dhe ekzekutive në lidhje me kthimin e personave të riatdhesuar janë marrë nga autoritetet e Kosovës.

*Rrethanat që ndërlidhen me riatdhesimin e detyrueshëm të ankuesit nga ShBA-ja*

17. Ankuesi është lindur në Kosovë në vitin 1954. Në vitin 1985 ai shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai qëndroi dhe punoi atje për njëzet e tre vitet vijuese.

18. Ankuesi deklaron se në vitin 1990, pas zhvillimeve politike në rajonin e ish-Jugosllavisë, ai ua paraqiti një kërkesë për azil autoriteteve të ShBA-së. Megjithatë, ai kurrë nuk mori ndonjë informatë rreth rezultatit të këtij aplikimi.

19. Në vitin 2004, autoritetet për imigrim të ShBA-së filluan procedurat për largim kundër ankuesit, për gjoja qëndrim më shumë se sa që duhej në vend që nga viti 1985, dhe kështu kishte shkelur ligjet e ShBA-së mbi imigrimin. Ankuesi deklaron që ai ishte i mbajtur në mënyrë të paligjshme për afërsisht katër vjet gjatë procedurave të largimit dhe se në fund të procedurave dhe apelimit të tijpasues, ai iu nënshtrua largimit nga ShBA-ja.

20. Më 6 maj 2008, pas lëshimit të një dokumenti të udhëtimit nga UNMIK-u, ankuesi u deportua nga ShBA-ja për në Kosovë. Ankuesi deklaron se, me deportimin e tij, atij nuk i është ofruar ndonjë ndihmë nga UNMIK-u apo ndonjë autoritet tjetër për t'i plotësuar nevojat e tij elementare për jetesë dhe për të përkrahur ri-integrimin e tij në shoqërinë e Kosovës. Ankuesi deklaron se ai është i prekur nga një sëmundje që nga lindja dhe që mungesa e qasjes në ushqim, akomodim dhe përkujdesje të duhur shëndetësore përkeqësoi gjendjen e tij. Ai deklaron më tutje se prej 30 majit të vitit 2008, ai u shkroi letra dhe provoi t'ua drejtojë kërkesat e veta për ndihmë zyrtarëve të lartë të UNMIK-ut, por nuk morindonjë informatë për të verifikuar praniminapo përgjigje.

21. Ankuesi paraqet dokumentet vijuese: kopjet e një letre që ai ia shkroi UNMIK-ut më 30 maj 2008, në të cilën ai kërkon ndihmë për t'u integruar në shoqërinë e Kosovës; raportin e një mjeku specialist të ortopedisë dhe traumatologjisë, të datës 11 tetor 2010, në të cilin thuhet se ai është i paaftë për punë; dhe një fotografi të dhomës së bodrumit në të cilin ai jetoi për një periudhë kohore të paspecifikuar pasi ishte deportuar nga ShBA-ja në maj të vitit 2008. Ai deklaron se në bodrum nuk kishte ngrohje apo ujë të vazhdueshëm. Ankuesi deklaron se

bodrumi ishte vendi i akomodimit të tij pasi "shtëpia ishte duke u ndërtuar" dhe se, kur në vitin 2011 ishte e gatshme", ai "u zhvendos lart në një dhomë që shërbente si bibliotekë" ku ai akoma jeton.

## III. ANKESA

22. Duke pasur parasysh se ankesa e tij është shpallur e pranueshme, ankuesi ankohet se UNMIK-u ndihmoi deportimin e tij në Kosovë pas njëzet e tre vjetësh të qëndrimit të vazhdueshëm në ShBA, pa i ofruar atij ndonjë ndihmë pas arritjes në Kosovë. Ai pohon se pas deportimit, ai ishte lënë pa strehim dhe ushqim të duhur, pa qasje në përkujdesje themelore sociale dhe mjekësore, pa punë dhe mjete financiare për të mbajtur veten.

23. Në lidhje me këtë, Paneli konsideron se ankuesi thirret në shkelje të së drejtës së tij për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues siç parashihet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së), si dhe në shkelje të së drejtës së tij për punë, siguri sociale dhe për standard adekuat të jetës siç garantohet me nenet 6, 9 dhe 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

## IV. LIGJI

### A. Parashtresat e palëve

#### 1. Parashtresat e ankuesit

24. Ankuesi deklaron se UNMIK-u si administratë e përkohshme në Kosovë në maj të vitit 2008, shkeli të drejtat e tij ekonomike dhe sociale duke mos i siguruar atij, pas deportimit në Kosovë, ndihmën e kërkuar për ta ri-integruar në shoqërinë e Kosovës dhe të ketë një standard të duhur të jetesës. Ankuesi deklaron që, pas riatdhesimit të tij në maj të vitit 2008, atij nuk i ishte siguruar ushqim i duhur, akomodim apo rroba. Ai ishte deportuar me 200 euro në xhep dhe, më pas, ai mund të llogariste vetëm në mbështetjen nga pensioni i nënës së tij që ishte në shumë prej 45 eurosh në muaj. Ai deklaron që ai është me sëmundje që nga lindja dhe, lënia për një kohë të gjatë pa punë, vend të duhur për të jetuar, përkujdesje shëndetësore dhe ushqim adekuat, kishte përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore.

#### 2. Parashtresat e PSSP-së

25. Në fillim, PSSP-ja thekson që, pas hetimeve të UNMIK-ut, Policia Kufitare e Kosovës konfirmoi që ankuesi ishte deportuar nga ShBA-ja në pajtim me ligjet e imigrimit të ShBA-së dhe arriti në Aeroportin e Prishtinës më 6 maj 2008. PSSP-ja thekson që, megjithatë, UNMIK-u "nuk ishte në gjendje të gjejë letrën të cilën ankuesi thuhet ta ketë dërguar më 30 maj 2008" për të kërkuar ndihmë dhe mbrojtje.

26. PSSP-ja thekson se nuk ka asnjë pretendim nga ankuesi se UNMIK-u i bëri atij drejtpërdrejtë ndonjë keqtrajtim. Duke pasur parasysh se ankuesi ankohet rreth shkeljes së të drejtave të tij ekonomike dhe sociale, PSSP-ja thekson se në rastin *Pancenko kundër Letonisë* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) thekson që Konventa Evropiane nuk garanton të

drejtat socio-ekonomike siç janë e drejta për punë, e drejta për ndihmë mjekësore falas apo e drejta për të marrë ndihmë financiare nga një shtet për të mbajtur një standard të caktuar të jetesës.

27. PSSP-ja pranon që, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kushtet jetësore të personit mund të hynin brenda fushës së nenit 3 të KEDNJ-së (ndalim i trajtimit jonjerëzor apo degradues) me kusht që të jetë arritur te "një nivel minimal i gjendjes së rëndë". Megjithatë, ai thekson që vendimi i Gjykatës Evropiane në rastin *M.S.S. kundër Belgjikës* i përmendur nga Paneli në vendimin e vet mbi pranueshmërinë, ka të bëjë me azilkërkuesit të cilët, si të tillë janë *prima facie* persona të cenueshëm dhe personat e tjerë, të cilët plotësisht varen nga shteti. PSSP-ja argumenton që ankuesi është "një banor i zakonshëm i Kosovës për të cilin cenueshmëria dhe varësia nga autoritetet qeveritare nuk mund të nënkuptohej pa ofrimin e informatave relevante".

28. PSSP-ja po ashtu thekson që një shkelje e nenit 3 të KEDNJ-së mund të gjendej në varësi nga reagimi i autoriteteve dhe qëndrimet e tyre kur situata është sjellë në vëmendjen e tyre. Në veçanti ai i referohet vendimit të Gjykatës Evropiane në rastin *Budina kundër Rusisë*, ku Gjykata konsideroi se nuk mund ta përjashtonte se përgjegjësia e shtetit do të mund të dilte ku një ankues që varet plotësisht nga mbështetja e shtetit përballet me indiferencën zyrtare në një situatë të varfërisë apo nevojës serioze që është në kundërshtim me dinjitetin njerëzor. Në lidhje me këtë PSSP-ja pohon se nuk ka asnjë dokumentacion apo dëshmi që UNMIK-u veproi në mënyrë jo të duhur kur iu përgjigj kërkesave për ndihmë të ankuesit në shkelje të nenit 3.

29. PSSP-ja thekson më tutje se më 28 nëntor 2007, UNMIK-u miratoi Politikën për kthim për t'i trajtuar, ndërtë tjera, personat që qëndronin pa status ligjor në vendet mikpritëse, duke përfshirë azilkërkuesit që u është refuzuar kërkesa për azil dhe ata që hynë në vend ilegalisht dhe/apo qëndruan më shumë sesa afati i vizës së tyre. Sipas kësaj politike dhe Strategjisë përcjellëse për ri-integrim, Institucioneve të Përkohshme relevante të Vetëqeverisjes në Kosovë u ishin caktuar përgjegjësitë për të siguruar kthim të sigurt dhe të dinjitetshëm të personave që i janë nënshtruar kthimit të pavullnetshëm, e cila po ashtu është cekur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/15, që plotëson Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 *mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*. PSSP-ja thekson se në janar të vitit 2008, UNMIK-u ia transferoi kompetencat lidhur me kthimin Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilës iu besua përgjegjësia për t'i bashkërenduar procedurat e kthimit dhe për të siguruar që grupet e cenueshme kanë pranuar ndihmë të mjaftueshme gjatë gjithë procesit të kthimit.

30. PSSP-ja argumenton që, në rastin aktual, i takonte ankuesit, në kohën e kthimit të tij, t'i informojë autoritetet kufitare apo autoritetet e tjera qeveritare për gjendjen e tij të cenueshmërisë, si dhe "t'u ofrojë informata relevante të cilat do t'u mundësonin autoriteteve të gjejnë mënyrën përmes së cilës atij do t'i ofrohej ndihma" në pajtim me Politikën për kthim dhe ri-integrim. PSSP-ja thekson që "për të qenë i qëndrueshëm ndonjë pretendim për indiferencë zyrtare, ankuesi duhet ta dëshmojë se ai informoi autoritetet relevante për gjendjen e tij dhe nevojën për mbështetje dhe se asgjë nuk ishte bërë për të trajtuar këtë situatë".

31. PSSP-ja pranon përgjegjësinë e UNMIK-ut për të siguruar nivel minimal të ndihmës bazëdheta këshillojë ankuesin në periudhën ndërmjet 6 majit të vitit 2008 dhe 15 qershorit të vitit 2008. Në lidhje me këtë, ai konsideron që deportimi i ankuesit ishte ndihmuar nga UNMIK-ut dhe që roli i UNMIK-ut përfshinte lëshimin e një dokumenti të udhëtimit më 5 mars 2008, i cili ishte i vlefshëm për gjashtë muaj. Megjithatë, nuk ka asnjë indikacion që UNMIK-u kishte qenë "i informuar për sëmundjen e caktuar të ankuesit para apo pas arritjes së tij apo për nevojën e tij për ndihmë".

32. Në dritë të kësaj që sapo u tha, PSSP-ja argumenton që ankesa është e papranueshme dhe qartë e pabazuar meqë, sipas mendimit të tij, ankuesi dështoi të ofrojë ndonjë dëshmi apo provë për pretendimet e tij kundër UNMIK-ut. Prandaj, ankesa sipas nenit 3 të KEDNJ-së, dhe neneve 6, 9, dhe 11 të KNDESK "hedhet poshtë në tërësi".

33. Në komentet e tij shtesë të datës 29 nëntor 2012 dhe 15 janar 2013, ankuesi së pari e konteston se ai ishe një "banor i zakonshëm i Kosovës" në kohën e deportimit të tij nga ShBA-ja, siç thuhet nga PSSP-ja. Ai deklaron se jetoi për 23 vjetnë ShBA dhe se, pasi ai ishte deportuar, ai duhej të nistegjithçka nga fillimi në Kosovë. Ai deklaron që, në të vërtetë, një letërnjoftim i ri dhe leje e vozitjes i ishin lëshuar atij, që të dyja mbanin logon e UNMIK-ut në to, dhe se në zgjedhjet e para dhe të dyta të mbajtura pas kthimit të tij në Kosovë, ai ishte lejuar të votojë vetëm si "votues me kusht", një status i përdorur për votuesit që nuk ishin banorë, por vetëm përkohësisht të pranishëm në Kosovë. Ankuesi argumenton që, si një banor jo i zakonshëm, ai nuk kishte asnjë njohuri për autoritetet dhe institucionet e Kosovës dhe, për këtë arsye, ai iu drejtua UNMIK-ut për ndihmë.

34. Për sa i përket argumentit të PSSP-së se ankuesi nuk ofroi dëshmi të mjaftueshme se ai iu drejtua autoriteteve të UNMIK-ut, ankuesi deklaron se kjo është një përpjekje për t'ia vënë fajin atij, në vend të pranimit se nuk ka asnjë mekanizëm të krijuar në Kosovë për t'itrajtuar rastet e të kthyerve, dhe në veçanti atyre që janë me paaftësi, sikur ai. Në lidhje me këtë, ai i referohet, po ashtu, Raportit për Vendin të vitit 2008 të Departamentit të Shtetit të ShBA-së mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut në Kosovë duke thënë që, pavarësisht nga fakti që Kushtetuta parasheh të drejta të barabarta për personat me paaftësi, ata janë neglizhuar nga autoritetet qeveritare dhe *de facto* janë diskriminuar. Ai, po ashtu, i referohet Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të datës 24 nëntor 2008, i cili, në Shtojcën II, thotë "Komunat pranuese nuk janë të vetëdijshme për përgjegjësitë e tyre për të ndihmuar ri-integrimin e personave të riatdhesuar në mënyrë të detyrueshme, dhe mjetet financiare nuk janë ndarë në nivel komunal për atë qëllim. Kjo tregon për një dështim të Qeverisë për të siguruar implementim të Strategjisë për ri-integrim të personavetë riatdhesuar" (shih Dok. E OKB-së S/2008/692, në § 34).

35. Ankuesi pohon më tutje se, madje edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ruajti një "rol të rëndësishëm" në Kosovë, pasi ai ruajti, së bashku me organizatat e tjera ndërkombëtare sikur Zyra Ndërkombëtare Civile, përgjegjësinëe ndarë për të "mbikëqyrur" pavarësinë e Kosovës. Ankuesi argumenton që në fakt UNMIK-ut dhe organizatat e tjera joqeveritare (p.sh. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë) punuan pas vitit 2008 në

kuadër të kornizës së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-sënr. 1244 (1999), me të cilën u themelua UNMIK-u.

## 3. Vlerësimi i Panelit

*Parimet e përgjithshme*

36. Ankuesi ankohet që UNMIK-u dështoi t'i ofrojë atij ndihmën e nevojshme pas kthimit të tij të detyrueshëm nga ShBA-ja, që përbën shkelje të së drejtës së tij të jetë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues (neni 3 i KEDNJ-së) dhe të drejtës së tij për punë, për siguri sociale dhe një standard adekuat të jetesës (neni 6, 9 dhe 11 i KNDESK-së).

37. Paneli i referohet praktikës së vendosur mirë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që tregon se neni 3, së bashku me nenin 2, ruan një nga vlerat më fundamentale në shoqëritë demokratike. Ai ndalon plotësisht torturën apo trajtimin jonjerëzor apo degradues apo dënimin,pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih, për shembull, GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, nr. 30696/09, vendimi i 21 janarit të vitit 2011, §§ 251-253; GJEDNJ [DHL] *Labita kundër Italisë*, nr. 26772/95, vendimi i 6 prillit të vitit 2000, në § 119).

38. Gjykata e konsideron trajtimin të jetë "degradues" kur ai poshtëron apo përul një individ, duke treguar mungesë respekti për të apo duke nënvlerësuar dinjitetin e tij/saj, apo duke shkaktuar ndjenja të frikës, shqetësimit apo inferioritetit që është në gjendje të thyejë rezistencën morale dhe fizike të individit (shih GJEDNJ, *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur më lart, në § 220; dhe *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, § 52, KEDNJ 2002-III). Gjykata thekson që "gjatë shqyrtimit nëse një formë e caktuar e trajtimit është "degraduese" në kuadër të kuptimit të nenit 3, Gjykata do ta ketë parasysh nëse synimi është të poshtërohet dhe përulet personi në fjalë dhe nëse, sa u përket pasojave, ajo ndikoi negativisht në personalitetin e tij/saj në një mënyrë që është e papajtueshme me nenin 3" (GJEDNJ, *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 41138/98 dhe 64320/01, vendimi i 12 korrikut të vitit 2015, në § 101; *Raninen kundër Finlandës*, vendimi i 16 dhjetorit të vitit 1997, raportet 1997-VIII, ff. 2821-22, § 55). Megjithatë, mungesa e një synimi apo qëllimi të tillë nuk mund ta përjashtojë përfundimisht shkeljen e nenit 3 (GJEDNJ, *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur më lart, në § 219; GJEDNJ, *Peers kundër Greqisë*, nr. 28524/95, vendimi i 19 prillit të vitit 2001, § 74).

39. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, keqtrajtimi arrinnjë nivel minimal të gjendjes së rëndë nëse bie në kuadër të nenit 3 (shih, në mes autoriteteve tjera, GJEDNJ, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 18 janarit të vitit 1978, seria A nr. 25, f. 65, § 162). Megjithatë, Gjykata ka theksuar që vlerësimi i këtij minimumi është relativ dhe varet "nga të gjitha rrethanat e rastit, siç janë kohëzgjatja e trajtimit, ndikimet e tij fizike dhe mentale dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës" (shih, në mes autoriteteve tjera, GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur më lart, në § 219 ; shih gjithashtu *Kudła kundër Polonisë* [DHL], nr. 30210/96, vendimi i 26 tetorit të vitit 2000, në § 91).

40. Gjykata ka theksuar që autoritetet duhet t'u ofrojnë mbrojtje të veçantë nga keqtrajtimi personave të cenueshëm dhe veçanërisht grupit të popullatës të paprivilegjuar dhe të cenueshme, sikur azilkërkuesit (GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 37 më lart, në § 251; *V.M. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr. 60125/11, vendimi i 7 korrikut të vitit 2015, në § 153), fëmijët(shih GJEDNJ, *Z. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, lënda nr. 29392/95, vendimi i 10 majit të vitit 2001, në § 73), personat me të meta mendore (GJEDNJ, *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, vendimi i 29 janarit të vitit 2013, në § 128).

41. Për sa u përket pretendimeve të ankuesit se, po ashtu, është shkelur e drejta e tij për punë, për siguri sociale dhe për një standard adekuat të jetesës, Paneli rikujton që, në pajtim me nenin 2 të KNDESK-së, i cili ka të bëjë me shtrirjen e obligimeve të shteteve sipas Konventës, pranohet që realizimi i plotë i këtyre të drejtave mund të jetë "progresiv", me kusht që autoritetet të marrin hapat e duhur dhe të ndajnë maksimumin e burimeve të tyre në dispozicion për këtë qëllim.

42. Megjithatë, Paneli rikujton që në komentin e vet të përgjithshëm mbi natyrën e obligimeve të palëve shtetërore, Komiteti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka theksuar që dispozitat e KNDESK-së, siç janë neni 6, 9 dhe 11, po ashtu detyrojnë obligime të cilat janë të efektit të drejtpërdrejtë, duke përfshirë: sigurimin që gëzohen "nivelet esenciale minimale" të secilës nga të drejtat në fjalë dhe obligimin për të garantuar se ushtrimi i këtyre të drejtave do të jetë i lirë nga diskriminimi. Veç kësaj, Komiteti ka nënvizuar që obligimet minimale bazë të theksuara më lart, vlejnë "po ashtu në kohët e kufizimeve të mëdha në resurse", ku autoritetet e kanë për obligim t'i mbrojnë "pjesëtarët e cenueshëm të shoqërisë" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 3 *mbi natyrën e obligimeve të palëve shtetërore*, 14 dhjetor 1990, Dok. i OKB-së E/1991/23, në § 12).

*Aplikueshmëria e parimeve të përgjithshme në rastin aktual*

43. Paneli në fillim, dhe në përgjigje ndaj vërejtjes së PSSP-së që të drejtat ekonomike dhe sociale nuk garantohen sipas KEDNJ-së, i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane, e cila konsideron që interpretimi i Konventës duhet të zgjerohet në sferën e të drejtave sociale dhe ekonomike. Gjykata ka theksuar se nuk ka "ndarje të plotë që ndan atë sferë nga fusha e të drejtave civile dhe politike që mbulohen nga Konventa" dhe që, për shembull një "shumë plotësisht e pamjaftueshme e pensionit dhe përfitimeve sociale" mund të ngritë një çështje sipas nenit 3 të Konventës (GJEDNJ, *Budina kundër Rusisë*, nr. 45603/05, vendimi i 18 qershorit të vitit 2009); dhe po ashtu GJEDNJ,*Larioshina kundër Rusisë* (dhjet.) nr. 56869/00, 23 prill 2002, përmendur aty). Gjykata ka theksuar që, si pasojë, ajo nuk mund ta përjashtojë "mundësinë që përgjegjësia e shtetit mund të gjendet [sipas nenit 3] për trajtimin ku një ankues, i cili plotësisht ka qenë i varur nga përkrahja e shtetit, e gjen veten përballë indiferencës zyrtare në një situatë të varfërisë apo nevojës serioze në kundërshtim me dinjitetin njerëzor" (shih GJEDNJ, *Budina kundër Rusisë*, nr. 45603/05, vendimi i 18 qershorit të vitit 2009; GJEDNJ[DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 37 më lart, në §§ 251-253).

44. Paneli thekson që nuk kontestohet nga PSSP-ja se UNMIK-u e kishte një përgjegjësi sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1244 (1999) dhe më pas rregulloreve të UNMIK-ut (p.sh. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 *mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë*), për të krijuar një sistem për kthimin e personave të riatdhesuar me origjinë nga Kosova, i cili plotësisht do të ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të aplikueshme për UNMIK-un, duke përfshirë ato që rrjedhin nga KEDNJ dhe KNDESK. Paneli thekson që,në të vërtetë, në periudhënmes viteve 2006 dhe 2007, UNMIK-u krijoi së bashku me IPVQ-të e Kosovës Politikën për kthim dhe Strategjinë për ri-integrim për këtë qëllim. Paneli thekson që, në Politikën për kthim, qartë thuhet që UNMIK-u ruajti kompetencat "e përgjithshme" për implementimin e procedurave të kthimit, pavarësisht nga fakti që disa përgjegjësi operacionale u ishin dorëzuar IPVQ-ve të Kosovës, kryesisht MPB-së (shih § 12 më lart).

45. Paneli thekson më tutje që njëjtë nuk kontestohet që, deri më 15 qershor 2008, UNMIK-u vazhdoi t'i ushtrojë kompetencat në Kosovë duke përfshirë ato që ndërlidhen me procedurat e kthimit, siç janë theksuar më lart. Në fakt, pranohet qartë nga PSSP-ja, që UNMIK-u ishte në parim përgjegjës për sigurimin e "një niveli minimal të ndihmësbazë" ankuesit në periudhën në mes arritjes së tij në Kosovë më 6 maj 2008 dhe 15 qershorit të vitit 2008 (shih § 31 më lart).

46. Megjithatë, PSSP-ja pohon që i takonte ankuesit t'i kontaktojë autoritetet relevante për t'i informuar ato për nevojën e tij për ndihmë dhe se ai nuk e dëshmoi se e bëri këtë, e as që e dëshmoi se UNMIK-u reagoi në mënyrë jo të duhur apo me indiferencë ndaj kërkesës së tij për ndihmë.

47. Paneli thekson se një sistem efektiv i ndihmës pas riatdhesimit duhet t'i ketë të vendosuranë vend procedurat, përmes të cilave mund të identifikohen personat e cenueshëm në nevojë të ndihmës dhe mbrojtjes së veçantë. Në të vërtetë Strategjia për ri-integrim e UNMIK-ut-IPVQ-ve e vitit 2007 për personat e riatdhesuar parashihte që të gjithë të kthyerve duhet ofruar "pritje fillestare dhe ndihmë në informata" në Aeroportin e Prishtinës nga stafi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të identifikimit të nevojave të menjëhershme (p.sh. transport dhe akomodim i përkohshëm), si dhe nevojave afatgjata (p.sh. përkujdesje shëndetësore, riparim shtëpie) të të kthyerve dhe t'ia përcjellë informatat e tilla Ministrisë Lokale të Administratës Publike (në fq. 8-9 të Strategjisë përmendur në § 11 më lart). Prandaj, Paneli përfundon që, madje edhe nëse për disa arsye letrat që përmbanin një kërkesë për ndihmë që thuhet se ankuesi ia dërgoi UNMIK-ut (shih §§ 20-21më lart), nuk iishin përcjellë zyrës apo personit relevant, një sistem efektiv për riatdhesim që është në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, është dashur të jetë në dispozicion dhe në gjendje ta identifikojë ankuesin si një person i cenueshëm, të vlerësojë nevojën e tij për ndihmë dhe t'i ofrojë atij mbështetjen e kërkuar. Paneli, po ashtu, thekson që asnjë dokumentacion në lidhje me këtë nuk është ofruar nga PSSP-ja.

48. Paneli, po ashtu, thekson se ka dëshmi për dështimet dhe të metat në implementimin e Politikës për kthim dhe Strategjisë për ri-integrim të UNMIK-ut-IPVQ-ve. Për shembull, Komisioni Evropian theksoi në Raportin e Progresit në Kosovë të vitit 2008, se Strategjia e

ri-integrimit "duhej implementuar" që nga nëntorii vitit 2008[5]. Veç kësaj, në raportin e vet të nëntorit të vitit 2009 mbi implementimin e Strategjisë për ri-integrim, OSBE-ja theksoi që, nga miratimi i saj në vitin 2007,"vetëm disa hapa" ishin ndërmarrë për ta zbatuar strategjinë në nivel lokal"[6]. Në këtë raport thuhet, në veçanti, se kishte një mungesë të përgjithshme të vetëdijes në mesin e autoriteteve relevante lokale për rolet dhe përgjegjësitë e tyre për riatdhesimin e personave, se nuk ishin miratuar masa konkrete për të ndihmuar ri-integrimin e tyre, dhe se nuk ishte krijuar asnjë mekanizëm referimi dhe asnjë shpenzim nuk ishte ndërlidhur me procesin e ri-integrimit. Shqetësim i ngjashëm për mungesën e implementimit të Politikës dhe Strategjisë së kthimit në Kosovë ishte shprehur nga Komisionari për të Drejtat e Njeriut i Këshilli të Evropës gjatë vizitës së tij në Kosovë në mars të vitit 2009, i cili vërejti se shumë nga ata që ishin kthyer në mënyrë të detyrueshme nuk ishin ndihmuar nga autoritetet relevante, duke u bërë të pa shtëpi pas riatdhesimit të tyre në Kosovë[7].

49. Paneli thekson që, madje edhe duke pranuar përgjegjësinë e UNMIK-ut për t'u ofruar ndihmë minimale bazë të riatdhesuarve, veçanërisht më të cenueshmëve, PSSP-ja thekson që vetë ankuesi nuk do të hynte në këtë kategori, duke pasur parasysh faktin që ai është një "banor i zakonshëm" i Kosovës, prandaj nuk varet plotësisht nga mbështetja e shtetit.

50. Në lidhje me këtë, Paneli nuk pajtohet me PSSP-në që ankuesi mund të quhej një banor i zakonshëm i Kosovës (shih § 27 më lart) në momentin e riatdhesimit të tij, duke pasur parasysh faktin (që nuk kontestohet nga PSSP-ja) që, para riatdhesimit, ai kishte jetuar pandërprerë për 23 vjet në ShBA. Paneli konsideron që, pas një mungese të tillë të gjatë nga Kosova, e cila përfshiu konfliktin e armatosur, si dhe pas transformimeve të mëdha sociale dhe politike në Kosovë, ankuesi nuk ishte më një pjesëtar i integruar i shoqërisë së Kosovës (shih § 33 më lart). Paneli, po ashtu, thekson që ankuesi thotë se ai ishte i prekur nga një sëmundje që nga lindja. Në çdo rast, Paneli po ashtu thekson faktin që të qenit "banor" nuk do ta mbronte një person nga shkelja e të drejtave të tij themelore ekonomike dhe sociale. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të përmendur më lart që madje edhe ata banorë që marrin pension apo përfitime të tjera sociale mund të pretendojnë për shkelje të nenit 3, kur këto janë "plotësisht të pamjaftueshme" për të jetuar me dinjitet (shih § 43 më lart). Në fund, Paneli rikujton që Gjykata Evropiane ka gjetur shkelje të nenit 3 madje edhe në rastet në të cilat situata nëskamje serioze, varfëri dhe nevojë për ata që u nevojitej mbrojtje e veçantë ka zgjatur për një periudhë kohore prej dy javësh (shih GJEDNJ, *V.M. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, përmendur në § 40 më lart).

51. Prandaj,Paneli përfundon që ankuesi ishte në një situatë që kërkonte nivel të ndihmësbazë nga UNMIK-u për t'i plotësuar nevojat e tij elementare në periudhën menjëherë pas deportimit të tij në Kosovë të cilën, megjithatë,ai nuk e mori për shkak të dështimit të sistemit për tëidentifikuar dhe vlerësuar nevojën e tij për mbështetje. Paneli konsideron që,

---

[5]Komisioni i KomuniteteveEvropiane, Raporti i ProgresitpërKosovën (nën RKSKB 1244/99) i vitit2008, 5 nëntor 2008, SEC (2008) 2697, nëfaq. 25.

[6]OSBE, Implementimi i Strategjisëpërri-integrimtëpersonavetëriatdhesuarnëkomunat e Kosovës, nëntor2009, nëfaq. 1.

[7]Raportpërvizitën e KomisionaritpërtëDrejtat e NjeriuttëKëshillittëEvropësnëKosovë, 23-27 mars 2009, në §§ 154-158.

për periudhën prej 6 majit të vitit 2008 deri më 15 qershor 2008, dështimi i tillë i atribuohet UNMIK-ut.

52. Paneli konsideron që ankuesi, si rezultat i dështimit të UNMIK-ut të përshkruar më lart pas deportimit të tij të detyrueshëm nga ShBA-ja, u gjet në një situatë të varfërisë dhe nevojës ekstreme që përbën trajtim jonjerëzor dhe degradues në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së. Paneli, po ashtu, konsideron që niveli shumë i kufizuar i ndihmës që UNMIK-u ia ofroi ankuesit nuk përmbushi obligimet minimale bazë sipas nenit 9 dhe 11 të KNDESK-së për t'indërmarrë hapat e duhur, deri në maksimum të resurseve në dispozicion, për të realizuar të drejtën e ankuesit për një standard adekuat të jetesës (neni 11) dhe siguri sociale (neni 9).

53. Megjithatë, Paneli nuk konsideron që periudha në të cilën UNMIK-u ruajti përgjegjësitë ekzekutive është e mjaftueshme për të konstatuar, po ashtu, shkelje të së drejtës së ankuesit për punë, siç parashihet me nenin 6 të KNDESK-së.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 3 TË KEDNJ-së DHE NENEVE 9 DHE 11 TË KNDESK-së;**

2. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 TË KNDESK-së.**

3. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

   a. **TË PRANOJË DËSHTIMIN E VET PËR TË SIGURUAR RIATDHESIM TË ANKUESIT NË PAJTIM ME PROCEDURAT RELEVANTE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DUKE SHKELUR NENIN3 TË KEDNJ-së DHE NENET 9 DHE 11 TË KNDESK-së, DHE T'I KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESIT;**

   b. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESIT PËR DËMIN MORAL NË LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË NENIT 3 TË KEDNJ-së DHE NENEVE 9 DHE 11 TË KNDESK-së;**

   c. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR ME AUTORITETET RELEVANTE NË KOSOVË QË TË SIGUROJË QË RIATDHESIMI I PERSONAVE ME ORIGJINË NGA KOSOVA BËHET NË PAJTIM ME PROCEDURAT E DUHURA DHE NË NJË MËNYRË TË TILLË QË ËSHTË NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E PRANUARA PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

**d. TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.**

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues